



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIK KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëgjend/Prodato Received/Deliverty	28-04	2022	2	viti Year
Organ /Jlesia Organ /Jednita Org /Unit	Hr /Prof Hr /Prof Prof No	Shtup / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	2486/2022		1/4	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.322/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 208/2022 të datës 04.03.2022 të parashtruar nga ankuesit

të cilët

me autorizim i përfaqëson avokat me adresë kundër organit të punësimit Komuna e Vushtrrisë, në çështje juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 28.04.2022, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.208/2022 e datës 04.03.2022 e parashtruar nga

**A r s y e t i m**

Grup ankuesish, që të gjithë të punësuar në Komunën e Vushtrrisë nëpërmjet përfaqësuesit së tyre me autorizim më datë 04.03.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Komunës së Vushtrrisë për mos kompensimin e shujtave ushqimore ditore sipas Vendimit të Kuvendit Komuna të Vushtrrisë të datës 29.07.2010 dhe Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.



Duke u bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli më datë 08.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve të organi i punësimit, ndërsa ky i fundit më datë 16.03.2022, ka dërguar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Në mbështetje të nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh natyrën e çështjes, me Vendimin Nr.26/2022 të datës 14.04.2022 të Kryetarit të Këshillit është vazhduar afati për vendosje të ankesës me numër A.208/2022 të datës 04.03.2022 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 1176/2022 të datës 04.03.2022 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin për avokati Vendimin e datës 29.07.2010; Përgjigjet në kërkesë të datës 03.02.2022 për secilin ankues; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1230/2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1400/2022 të datës 16.03.2022; Emalin e datës 10.03.2022; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 610/2012 të datës 04.06.2012; Akt-in e Emërimit me numër të protokollit 217/2017 të datës 06.03.2017; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 39/16 të datës 25.01.2016; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 1125/2015 të datës 02.11.2015; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 634 të datës 25.01.2019; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 1059/2016 të datës 04.11.2016; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 620 të datës 25.01.2011; Akt-in emërimit me numër të protokollit 361/16 të datës 25.01.2016; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 1336/2019 të datës 25.11.2019; Akt-in e emërimit me numër AE.ne.20-035/02-0038199/21 të datës 02.08.2021; Akt-in e emërimit me numër AE.nr.20-035/02-0038189/21; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 789/14 të datës 02.06.2014; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 883/2013 të datës 09.07.2013; Akt-in e emërimit me numër AE.nr.20-035/02-0038203/21 të datës 02.08.2021; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 717/20 të datës 01.09.2020; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit me numër të protokollit 1168/19 të datës 09.10.2019; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 1285 të datës 14.02.2011; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 776/2018 të datës 07.06.2018; Akt-in e emërimit me numër AE.nr.20-035/02-0038522/21 të datës 03.08.2021; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 861 të datës 01.02.2011; Akt-in e emërimit me numër të protokollit 174/18 të datës 12.02.2018; Akt-in e emërimit me numër A.E.nr.20-035/02-0038193/21 të datës 02.08.2021; Procesverbalin e datës 29.07.2010; emalin i datës 27.04.2022 me numër protokollit 2434/2022, emalin e datës 27.04.2021 me numër protokollit 2434/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave të lëndës, konstatoi së është e pabazuar ankesa e ankuesve, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesit janë të punësuar në Komunën e Vushtrrisë dhe atë: ankuesja sipas Akt emërimit të datës 04.06.2012 është e punësuar në pozitën *Përkthyes* dhe *anasjelltas* në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 06.03.2017 është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile 1* në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 25.01.2016, është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Tatimit në Pronë* në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 02.11.2015 është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile* në Drejtorinë e Administratës së





Përgjithshme, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 10.01.2011 është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile* në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, ankuesja sipas Akt emërimit të datës 04.11.2016, është e punësuar në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile 1* në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 10.01.2011, është e punësuar në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile 1* në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme Sektori Gjendja Civile, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 25.01.2016, është i punësuar në pozitën *Zyrtar Profesional për Punë të Kuvendit* në Zyrën e Kryetarit në Sektorin Sekretaria e Komunës, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 25.11.2019, është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile* në Drejtorinë e Administratës, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 02.08.2021, është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile 1* në Drejtorinë e Administratës Sektori Gjendja Civile, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 02.08.2020 është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile 1* në Drejtorinë e Administratës Sektori Gjendja Civile, ankuesja sipas Akt emërimit të datës 02.06.2014 është e punësuar në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile* në Administratën e Përgjithshme, ankuesja sipas Akt emërimit të datës 09.07.2013 është e punësuar në pozitën *Zyrtar për Kurorëzim* në Sektorin e Gjendjes Civile, ankuesja sipas Akt emërimit të datës 02.08.2021 është e punësuar në Komunën e Vushtrrisë, në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile 1* në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme Sektori Gjendja Civile, ankuesi sipas Akte emërimit të datës 01.09.2020 është i punësuar në pozitën *Zyrtar për Vlerësimin e Pronësisë së Pabujshme*, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, ankuesi Jeton Salihu sipas ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 09.10.2019 është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Lartë i Personelit*, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 14.02.2011, është i punësuar në pozitën *Shef i Sektorit të Gjendjes Civile* në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme sektori Gjendja Civile, ankuesja sipas Akt emërimit të datës 07.06.2018 është i punësuar në pozitën *Zyrtar për Çështje Ligjore* në Sektorin e Administratës, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 03.08.2021 është i punësuar në pozitën *Udhëheqës i Sektorit për Shërbime të Përbashkëta dhe Teknologji Informative*, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 01.02.2021 është i punësuar në pozitën *Udhëheqës i Personelit*, ankuesja sipas Akt emërimit të datës 12.02.2018 është e punësuar në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile* në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, ankuesja sipas Akt emërimit të datës 02.08.2021 është e punësuar në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile* në Drejtorinë e Administratës në Sektorin e Gjendjes Civile.

Ankuesit me datë 17.12.2021 i janë drejtuar me kërkesë Komunës së Vushtrrisë konkretisht Departamentit për Buxhet dhe Financa për realizimin e shujtave ushqimore sipas vendimit të Punëdhënësit të datës 29.07.2010 si dhe Ligjit Nr.03/L-212 të Punës. Komuna e Vushtrrisë-Departamenti për Buxhet dhe Financa në përgjigje të kërkesës së ankuesve me datë 03.02.2022, ka njoftuar ankuesit së Komuna e Vushtrrisë nuk ka bërë planifikimin dhe ndarjen e mjeteve buxhetore për shujta ditore të punëtorëve të komunës. Pas kësaj përgjigje ankuesit ushtrojnë ankesë me bazë të njëjtë ankimore në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Kuvendi Komunal i Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datë 27.07.2010 ka miratuar Vendimin për lejimin e mjeteve buxhetore për pagesë të shujtës ditore në vlerë prej 2 euro për shërbyesit civil të administratës së



komunës, duke filluar nga data 01.04.2010, duke përcaktuar në nenin 4 se vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij në mbledhjen e Kuvendit.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ju referua nenit 144 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me te cilin është përcaktuar se: *Akti administrativ nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga koha kur akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi, apo kanë kaluar 3 (tre) vite nga veprimi i fundit për ekzekutimin, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe meqenëse nga data e miratimit të Vendimit të datës 27.07.2010 të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë kanë kaluar mbi pesë vite si dhe duke marrë parash faktin në shkresat e lëndës Kolegji nuk ka gjetur asnjë dëshmi së është ndërmarr ndonjë veprim për ekzekutimin e tij, kështu që mbi këto arsye ligjore Kolegji konstaton se Vendimi në fjalë mbi bazën e të cilit ankuesit kanë parashtruar ankesë është i pa ekzekutueshëm, përkatësisht nisur nga ky konstatim rezulton së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë Juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** Lënda me numër A.Nr.208/2022

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

*Procesmbajtëse*



#### **Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueseve avokatit
- Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vushtrrisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së

